REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

*Nr. 1271 . Prot* *Lezhë, më 31 / 7 /2023*

**VENDIM**

**Nr. 20, Datë 27. 07. 2023**

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE TË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE PËR PBA-në 2024-2026 (Faza e II-të) TË BASHKISË LEZHË.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore"; dhe në zbatim të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi:**

**1.**Miratimin e Tavaneve të Shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2024-2026 (Faza e II-të) të Bashkisë Lezhë, sipas pasqyrës dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.

**2.**Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**3.**Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**SEKRETARI**
**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**
**NDUE LULI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, L."Skënderbej", Kodi Postar 4501, e-mail: florida.cunaj@lezha.gov.al, web : www.lezha.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA LEZHË**
*Drejtoria e Buxhetit dhe Financës*

# RELACION

## *Mbi përgatitjen e Tavaneve Buxhetore për PBA-në 2024-2026 të Bashkisë Lezhë për fazën e dytë.*

Të nderuar këshilltarë!

Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit ka përgatitur projekt/dokumentin për tavanet e shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2024-2026 për fazën e dytë, në mënyrë analitike dhe të strukturuar, bazuar në kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.04. 2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministritë të Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me Udhëzimin nr.7, datë 25.02.2022; në Udhëzimin e MFE nr.6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" dhe Udhëzimin Plotësues të MFE nr.21, datë 07.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026".

Projekt/dokumenti i tavaneve të shpenzimeve për PBA-në 2024-2026, paraqet një prezantim të programeve buxhetore dhe nivelin e shpenzimeve sipas grup strukturës ekonomike, ku mundëson realizimin e funksioneve të veta. Projekt/dokumenti i tavaneve të PBA-së jep një informacion për programet dhe financimin e tyre për tre vitet e ardhshme 2024-2026. Në këtë projekt/dokument paraqitet në mënyrë të detajuar plani financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve për tre vitet e ardhshme, sipas programeve buxhetore.

Në këtë fazë të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, e cila është faza teknike, merret vendimi për tavane të qëndrueshme, të bazuar në politikat e zhvillimit, të cilat duhen respektuar në fazën finale.

Për përcaktimin e tavaneve janë marrë në konsideratë të dhënat e shpenzimeve të realizuara dhe të parashikuara për përiudhën 3 vjeçare 2021-2023, të dhënat mbi të ardhurat që krijohen nga burimet e veta (taksat dhe tarifat), transfertat nga burimet qëndrore, politikat e zhvillimit për çdo program dhe zbatimi i objektivave strategjikë

të miratuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

Bazuar në raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave vendore, në transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për Bashkinë Lezhë që jepen nga Qeveria Qëndrore, rezulton se burimet (të ardhurat) dhe shpenzimet janë për tre vitet e ardhshme 2024-2026 si më poshtë:

Treguesit kryesore ekonomik dhe financiar për vitet 2024-2026

Në mijë lekë

| Nr | Emërtimi | Sipas viteve | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2024 | 2025 | 2026 |
| **I** | **BURIMET GJITHSEJ** | **1,679,043** | **1,717,807** | **1,774,309** |
| **I.a** | **Nga Burimet e Veta** | **996,047** | **1,009,302** | **1,039,581** |
| 1 | Të ardhurat nga taksat vendore | 619,664 | 634,778 | 653,821 |
| 2 | Të ardhurat nga tarifat vendore | 330,103 | 338,155 | 348,300 |
| 3 | Të ardhurat e tjera | 46,280 | 36,369 | 37,460 |
| **I.b** | **Nga Burimet Qëndrore** | **682,996** | **708,505** | **734,728** |
| 1 | Transferta e Pakushtëzuar | 428,730 | 451,696 | 475,351 |
| 2 | Transferta Sektoriale | 254,266 | 256,809 | 259,377 |
| **II** | **SHPENZIMET GJITHSEJ** | **1,679,043** | **1,717,807** | **1,774,309** |
| **II.a** | Shpenzimet për Tavanet Buxhetore | 1,663,885 | 1,701,891 | 1,757,439 |
| **II.b** | Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës | 15,158 | 15,916 | 16,870 |

☞Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për tre vitet e adhshme janë pasqyruar në përputhje me të dhënat e miratuara. Për vitin 2024 parashikohet rritje e të ardhurave rreth 1.$^{5}$% në krahasim me vitin 2023; për vitin 2025 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 1.$^{3}$% në krahasim me vitin 2024 dhe për vitin 2026 parashikohet një rritje e të ardhurave 3% në krahasim me vitin 2025.

☞ Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2024 parashikohet me një rritje rreth 5.$^{39}$% në krahasim me vitin 2023, për vitin 2025 parashikohet me një rritje 5.$^{36}$% në krahasim me vitin 2024, dhe për vitin 2026 parashikohet me një rritje 5.$^{24}$% në krahasim me vitin 2025.

☞ Transferta sektoriale ndër vite është parashikuar me rritje 1% nga viti në vit.

☞Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për përiudhën 2024-2026 janë parashikuar sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026".

Në përcaktimin e tavaneve përgatitore është përdorur metodologjia e buxhetimit mbi bazë programi dhe përformance (BPP) duke siguruar lidhje midis burimeve publike (input-$_{ve}$), produkteve, rezultateve mbi bazën e politikave dhe objektivave për çdo program buxhetor, si dhe kostove për çdo aktivitet dhe në metodologjinë e re të përcaktuar sipas shtojcës 5.

Projekt/dokumenti i tavaneve buxhetore bën pasqyrimin e shpenzimeve për 8 programe, të miratuar nga GMS-ja, ku respektivisht jepen të dhënat në vlerë dhe përqindje për çdo program buxhetor:

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore

Në mijë lekë

| Kod Progr. | Programi | 2024 | | 2025 | | 2026 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Në vlerë | Në % / totalit | Në vlerë | Në % / totalit | Në vlerë | Në % / totalit |
| AA127 | Shërbimet Administrative e Menaxheriale | 194,688 | $11.^{6}$ | 201,869 | $11.^{7}$ | 234,230 | $13.^{2}$ |
| AB127 | Rendi dhe Siguria Publike | 90,694 | $5.^{4}$ | 91,986 | $5.^{4}$ | 173,640 | $9.^{8}$ |
| AC127 | Çështje ekonomike dhe tregtare | 239,075 | $14.^{2}$ | 90,976 | $5.^{3}$ | 223,885 | $12.^{6}$ |
| AD127 | Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet | 674,355 | $40.^{2}$ | 610,713 | $35.^{6}$ | 633,671 | $35.^{7}$ |
| AE127 | Turizmi dhe Kultura | 76,244 | $4.^{5}$ | 41,166 | $2.^{4}$ | 117,358 | $6.^{6}$ |
| AF127 | Arsimi, Rinia dhe Sporti | 334,223 | $19.^{9}$ | 408,701 | $23.^{8}$ | 293,035 | $16.^{5}$ |
| AG127 | Përkujdesi Social dhe Strehimi | 54,606 | $3.^{3}$ | 256,480 | $14.^{9}$ | 81,620 | $4.^{6}$ |
| AH127 | Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës | 15,158 | $0.^{9}$ | 15,916 | $0.^{9}$ | 16,870 | $1.^{0}$ |
| | **T O T A L I** | **1,679,043** | **$100.^{0}$** | **1,717,807** | **$100.^{0}$** | **1,774,309** | **$100.^{0}$** |

Është bërë parashikimi i shpenzimeve për investime, ku përcaktimi i tyre është bazuar në dokumentat strategjikë të bashkisë, si: Planit të Përgjithshëm Vendor, Strategjisë së Zhvillimeve Sektorial, prioriteteve të miratuara, dhe respektimi i kritereve prioritare dhe rregullave bazë për financimin e tyre.

Në lidhje me përcaktimin e tavaneve përgatitore të PBA-së 2024-2026, janë mbajtur parasysh edhe këto kritere bazë, si;

☞ Angazhimet buxhetore, ku përfshihen të gjitha shpenzimet për kontratat e lidhur, siç janë shpenzimet për mallra e shërbime dhe investimet në proces, etj.

☞ Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të krijuara ndër vite, të parashikuara për t'u likujduar gjatë 3 viteve.

☞ Pesha e shpenzimeve kapitale dhe shërbimeve publike me burim financimi nga burimet e veta janë në rritje nga viti në vit, kjo për të mundësuar përmirësimin e shërbimeve dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

☞ Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore pësojnë rritje rreth $3.^{5}$-$3.^{6}$% ndër vite, kjo referuar vjetërsisë në punë të punonjësve dhe treguesit të inflacionit.

☞ Shpenzimet e tjera korente kanë pësuar rritje ndër vite, kjo për arsye të rritjes së fondeve për shërbimet sociale, ndërsa shpenzimet administrative vijnë në ulje nga viti në vit.

☞ Në përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve një vëmendje e vecantë është treguar

në përcaktimin e shpenzimeve për nënprogramin e Mbrojtjes Civile, ku shpenzimet në këtë nënprogram zënë rreth 5 % të buxhetit.

☞ Si përfundim, në mënyrë të detajuar dhe analitike jepen Tavanet sipas Programeve Buxhetore, bashkëlidhur këtij projektvendimit.

Lezhë, më 14.07.2023

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

**Brikena Vuksani**

# Tavanet e Programeve Buxhetore

| | | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|
| **AA127** | **Shërbimet Administrative dhe Menaxheriale** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 131,534 | 138,112 | 145,016 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 60,154 | 60,757 | 61,871 |
| | Shpenzimet kapitale | 3,000 | 3,000 | 27,343 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **194,688** | **201,869** | **234,230** |
| **AB127** | **Rendi dhe Siguria Publike** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 54,697 | 55,889 | 57,228 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 35,997 | 36,097 | 36,412 |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 80,000 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **90,694** | **91,986** | **173,640** |
| **AC127** | **Çështjet e Përgjithshme Ekonomike** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 46,415 | 48,216 | 50,199 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 37,660 | 37,760 | 37,952 |
| | Shpenzimet kapitale | 155,000 | 5,000 | 135,734 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **239,075** | **90,976** | **223,885** |
| **AD127** | **Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet Publike** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 129,561 | 135,509 | 141,743 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 178,171 | 178,171 | 179,947 |
| | Shpenzimet kapitale | 366,623 | 297,033 | 311,981 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **674,355** | **610,713** | **633,671** |
| **AE127** | **Turizmi dhe Kultura** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 28,437 | 29,859 | 31,351 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 10,807 | 10,807 | 10,915 |
| | Shpenzimet kapitale | 37,000 | 500 | 75,092 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **76,244** | **41,166** | **117,358** |
| **AF127** | **Arsimi, Rinia dhe Sporti** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 189,398 | 192,403 | 195,596 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 80,054 | 80,154 | 80,739 |
| | Shpenzimet kapitale | 64,771 | 136,144 | 16,700 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **334,223** | **408,701** | **293,035** |
| **AG127** | **Përkujdesja Sociale dhe Strehimi** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 37,478 | 39,352 | 41,320 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 17,128 | 17,128 | 17,300 |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 200,000 | 23,000 |
| | **Tavanet e përgjithshme** | **54,606** | **256,480** | **81,620** |
| **AH127** | **Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës** | | | |
| | Pagat dhe sigurimet shoqërore | 0 | 0 | 0 |
| | Të tjera shpenzime korrente | 15,158 | 15,916 | 16,870 |
| | Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Tavanet e përgjithshme | **15,158** | **15,916** | **16,870** |
| | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 0 | 0 | 0 |
| Të tjera shpenzime korrente | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | **0** | **0** | **0** |
| | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 0 | 0 | 0 |
| Të tjera shpenzime korrente | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | **0** | **0** | **0** |
| | | | |
| Pagat dhe sigurimet shoqërore | 0 | 0 | 0 |
| Të tjera shpenzime korrente | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzimet kapitale | 0 | 0 | 0 |
| **Tavanet e përgjithshme** | **0** | **0** | **0** |
| | | | |
| TOTALI PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE | 617,520 | 639,340 | 662,453 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE TË TJERA KORRENTE | 435,129 | 436,790 | 442,006 |
| TOTALI I SHPENZIMEVE KAPITALE | 626,394 | 641,677 | 669,850 |
| **TOTALI I TAVANEVE TË PËRGJITHSHME** | **1,679,043** | **1,717,807** | **1,774,309** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **TOTALI FONDEVE NË PËRQINDJE (%)** | **0.9%** | **0.9%** | **1.0%** |
| **TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË** | **15,158** | **15,916** | **16,870** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 11271 / 1 prot
Dt. 04. 8. 2023

**PREFEKTI I QARKUT LEZHË**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr. 585/16 Prot.

Lezhë, më 03.08.2023

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin16 pika 2 gërma "b"të ligjit Nr.107/2016,datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68.datë 27.04.2017"Për financat e Vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.6.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar"; Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.23 ,datë 30.07.2018"Për proçedurat standarte të përgaditjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetqeverisjes vendore" të ndryshuar si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nr.6 ,datë 28.02.2023 "Për përgaditjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.20 ,datë 27.07.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë " Për miratimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2024-2026( faza e dytë ) të bashkisë Lezhë".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

Adresa: Lagjja "Skenderbej" Lezhë prefektura_lezhe@yahoo.com Tel. & Fax. 0215 22202